

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Video - SYRI TV/ Neviçishti pa nxënës, shkolla mbyll dyert, në fshat kanë mbetur vetëm të moshuar
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/916583/syri-tv-nevicishti-pa-nxenes-shkolla-mbyll-dyert-ne-fshat-kane-mbetur-vetem-te-moshuar/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:26:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:05:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0ff9b100b10bce4c32d7804a255ab6cc48ed6de89b98fe32cd4880667206db24
TEKSTI	b32116f57f44a4501e201159eb578179a5ee3f6b432f18fc760ffb2c9604ce63
PAMJA	b8549b0cef0a4b4f57e76e8685162bc91bf26b4931d5a9779ee8d94e9635195f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	17c6f10b7bb12c40dff9f387ea8446517df093ca86b45f230925fb2c39da7271
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e0b9829abb6e6aef0cbff9f89c7cd5e0dcc89e0fb08f67ff94e9a06c82fe2c5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/17c6f10b7bb12c40dff9f387ea8446517df093ca86b45f230925fb2c39da7271>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën



më të lexuarat



Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-vjeçare/ Banorët: Duan t'na marrin jetën! Kalaja: Fushë-Kruja ndahet përgjysmë



SYRI TV/ Pas ngujimit në zyra, Bankers tërhiqet, banorët arrijnë marrëveshje me firmën




Horoskopi, 13 shtator/ Zbulohet çfarë parashikojnë yjet për secilën shenjë



Këshillat e ekspertëve: 5 gjëra që nuk duhet t'i ndani me ChatGPT



Shqipëria po përballet me çmime ushqimore më të shtrenjta se mesatarja europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në BE



'Viti i ri shkollor nis në një mjedis të polarizuar social'/ Sindikata e Arsimit: Politikat arsimore, të pa mjaftueshme



SYRI TV/ Neviçishti pa nxënës, shkolla mbyll dyert, në fshat kanë mbetur vetëm të moshuar

16:05, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Zonat rurale të vendit po zbrazen, ndërsa shkollat po boshatisen. Në Neviçisht të Korçës, shkolla 9-vjeçare nuk ka hapur dyert këtë vit për shkak të mungesës së nxënësve. E njëjta situatë vihet re edhe në zona të tjera rurale, ku emigrimi dhe largimi i të rinjve kanë sjellë një rënie të ndjeshme të numrit të fëmijëve. Në Linaj të Malësisë së Madhe, vetëm 5 nxënës kanë nisur këtë vit shkollën. Ky realitet tregon edhe përmasat e tkurrjes demografike në fshatrat shqiptarë.

Shkolla e Neviçishtit, në Bashkinë e Korçës, këtë vit nuk do të presë nxënësit në nisjen e vitit të ri shkollor. Klasat dhe bankat ku për vite me radhë është zhvilluar mësimi tashmë kanë mbetur bosh. Për banorët e fshatit, kjo shkollë, për dekada me radhë, ka qenë vendi ku breza të tërë fëmijësh kanë mësuar, ndaj mbyllja e saj shihet si tregues i zbrazjes së fshatit dhe mungesës së brezit të ri.

Neviçishti është një prej fshatrave që po përballet me tkurrjen e vazhdueshme të popullsisë. Familjet e reja janë larguar, shumë të tjerë kanë emigruar, ndërsa në fshat kanë mbetur kryesisht banorë të moshës së tretë.

Por Neviçishti nuk është rasti i vetëm që mungesa e nxënësve e ka kthyer në simbol të boshatisjes së zonave rurale. Si shkak i emigrimit masiv, edhe në fshatrat e Qarkut të Shkodrës ka pakësim të ndjeshëm të nxënësve. Në fshatin Linaj të Malësisë së Madhe, vetëm 5 nxënës e kanë nisur vitin e ri shkollor në shkollën 9-vjeçare.

Banorët tregojnë se në këtë zonë nuk ka as martesat dhe të rinjtë largohen, pasi nuk shohin të ardhme në këtë vend.

Shifrat e arsimit pasqyrojnë një realitet demografik që prej vitesh po bëhet gjithnjë e më i dukshëm: më pak fëmijë në shkolla, më pak familje në fshatra dhe largime të vazhdueshme të popullsisë.

© SYRI.net

Lexo edhe:



SYRI TV/ Të pamundur për të blerë mjetet mësimore, fëmijët e familjes Dopi rrezikuan shkollën



Viti i ri shkollor, tkurret numri i nxënësve, shpopullimi zbraz klasat! Në Tiranë 20 shkolla vazhdojnë mësimin me turne



'Viti i ri shkollor nis në një mjedis të polarizuar social'/
Sindikata e Arsimit: Politikat arsimore, të pa mjaftueshme

Brenda kolapsit të agjencisë së
surrogacisë që u kushtoi grave surrogate
dhe prindërve të ardhshëm ëndrrat e
paratë e tyre

VIDEO/ Elbasan, tension në Këshillin
Bashkiak, opozita: Fondi i emergjencave
nuk po përdoret nga mungesa e
planifikimit

Viti i ri shkollor, tkurret numri i
nxënësve, shpopullimi zbraz klasat! Në
Tiranë 20 shkolla vazhdojnë mësimin me
turne

TË NGJASHME



Dita e parë e shkollës në Kavajë,
kryebashkiaku Fisnik Qosja mesazh
urimi për të gjithë nxënësit



Durrës/ Gjinnazi 'Gjergj Kastrioti' i
mbyllur prej 7 vitesh! Në Fllakë
fëmijët mësim në klasat pa xhama e
mes ferrave



Vlonjatët po ikin nga Vlora/ Më pak
nxënës në klasën e parë, në bankat e
shkollës dhe fëmijë ukrainas



Pesimizmi, dashuria dhe paratë – Ja
çfarë kanë rezervuar yjet në këtë 14
shtator



Numri i nxënësve në qarkun e Korçës
po tkurret/ Këtë vit gati 700 më pak
në bankat e shkollës



Berati po boshatiset/ Bie ndjeshëm
numri i nxënësve në shkollat 9-
vjeçare dhe të mesme, dhe ata që
hyjnë në klasën I



Shpopullimi në qarkun e Elbasanit/
Viti i ri shkollor nis me më pak fëmijë
në bankat e klasës së parë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.